

Emri i Lëndës : Metodat e Kërkimit dhe Shkrimi Akademik							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 305	A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Alban Tufa, Msc					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik pohon se në të vërtetë me anë të këtij përcaktimi kuptohet një teori e nyjtuar, konceptet operative të së cilës përdoren për të nxënë njohuri që janë në funksion të zgjidhjeve të problemeve, të ndërtimit dhe përkufizimit të koncepteve për strategji zhvillimore, planifikim strategjik, për menaxhim efektiv. Metodat e Kërkimit dhe Shkrim Akademik ndihmojnë në përgatitjen e një punimi të mirë, që njëherazi mund të vlejë për të rifituar besimin në dobinë dhe vlerën përparimjellëse të të studiuarit, të kuptuar jo thjesht si grumbullim të dhënash, por si përpunim kritik i një përvoje, si fitim aftësie (të vlefshme për të ardhmen) për të zbuluar problemet, për t'i trajtuar në mënyrë metodike ato dhe për t'i parashtruar sipas disa mënyrave komunikuese të caktuara. Ky kurs ligjëratash ka për qëllim të shpjegojë se si mund të kryhet një studim që mbështetet në metodën e duhur, duke dhënë kështu ndihmesë teoriko-kritike-analitike rreth dobisë së të marrit me studime, por dhe do të udhëzojë e ndihmojë lidhur me mënyrën se si mund të punohet një punim konkret. Thënë më shkurt, programi përmban sasi të mjaftueshme të materialeve teorike, për t'i dhënë rëndësi të veçantë punës praktike, nga e cila krijohet një bazament i qëndrueshëm për të ndërtuar intelektualisht.					
Objektivat							
Konceptet Kryesore		1. Kërkim 2. Shkrim akademik 3. Metoda kërkimore 4. Qasje kërkimore 5. Literaturë 6. Burime 7. Analizë					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Çfarë është kërkimi shkencor dhe shkrimi akademik • Rëndësia dhe arsyet pse ne shkruajmë? • Llojet e shkrimit, kundrejt shkrimit akademik; • Shkrimet subjektive dhe shkrimet objektive; • Projektet, esetë dhe projektet e mëdha kërkimore; • Çfarë është hulumtimi? • Pse duhet një punim formal? “Mjeshtria e Hulumtimit: Si të shkruash thjesht dhe qartë”. Wayne C. Booth; Gregory C. Colomb; Joseph M. Williams; Joseph Bizub; William T. Fitzgerald, Papirus, Tiranë 2016, faqe 11-32					
2		Përzgjedhja e një qasjeje kërkimore • Përcaktimi i qasjes në një kërkim shkencor; • Identifikimi i një botëkuptimi me të cilin operohet përgjatë punimit; • Përcaktimi i tre llojeve të qasjeve kërkimore; • Trajtimi dhe përdorimi i modeleve dhe metodave sasiore, cilësore dhe të përziera. “Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods” John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 41-61					
3		Rishikimi i literaturës • Vlerësimi nëse një temë është apo jo e kërkueshme; • Hapat ose fazat në të cilat kalon rishikimi i literaturës; • Përdorimi i bazave të të dhënave të kompjuterizuara të disponueshme për rishikimin e literaturës; • Zhvillimi i një përparësie për llojet e literaturës për t'u rishikuar; • Krijimi i një harte mbi literaturën; • Shkrimi i një abstrakti të mirë në një studim kërkimor; • Përdorimi i elementeve të rëndësishëm të një manuali stili; • Përcaktimi i termave (fjalët kyçe); • Aplikimi i një modeli rishikimi literature; “Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods” John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 62-89					

4	Përdorimi i teorive dhe burimet • Testimi i pretendimeve shkakësore në kërkimet sasiore; • Identifikimi i variablave në një studim sasiore; • Përcaktimi i natyrës së një teorie sasiore; • Llojet e burimeve dhe përdorimi i tyre; • Aplikimi i një plani për të shkruar një perspektivë teorike në një studim sasiore; • Marrja në konsideratë e llojet të teorive të përdorura në kërkimin cilësor; • Vendosja e teorive në një studim cilësor; • Vendosja e një lenteje teorike në një studim të metodave të përziera. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 90-124
5	Strategjitë e të shkruarit dhe shkrimi në mënyrë etike • Vlerësimi i strukturës së një propozimi për studime cilësore, sasiore dhe të përziera; • Përdorimi i strategjive të shkrimit për hartimin e një propozimi; • Zhvillimi i zakonit të të shkruarit; • Ndërtimi i mendimeve ombrellë, mendimeve të mëdha, mendimeve të vogla dhe mendimeve të imëta në shkrim; • Zhvillimi i qëndrueshmërisë së shkrimit përmes teknikës grep-and-eye; • Përdorimi i parimeve të shkrimit të prozës së mirë; • Parashikimi i çështjeve etike në shumë faza të procesit të kërkimit; • Evitimi i plagjiaturës dhe përdorimi i ideve të të tjerëve. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 125-156
6	Shkrimi i hyrjes në një punim shkencor • Shkrimi i një abstrakti për një studim; • Hulumtimi i dallimeve midis metodave sasiore, cilësore dhe të përziera; • Përdorimi i modelit të mangësisë për të shkruar një hyrje; • Hartimi i një gjetje të mirë narrative; • Shkrimi për problemin e kërkimit; • Përmbledhja e literaturës për një problem kërkimor; • Evidentimi i mangësive në literaturën e kaluar; • Marrja parasysh e lexuesve që mund të përfitojnë nga studimi. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 158-177
7	Parashtrimi i qëllimit në një punim dhe shkrimi i draftit të parë • Aplikimi i një drafti për të shkruar një parashtrim me qëllime cilësore; • Marrja parasysh se si do të ndryshonte skenari në varësi të modelit cilësor; • Përdorimi i një drafti për të shkruar një parashtrim me qëllim sasiore; • Marrja parasysh se si do të ndryshonte drafti në varësi të modelit sasiore; • Përdorimi i një drafti për të shkruar një parashtrim rreth metodave të përziera; • Marrja parasysh se si do të ndryshonte drafti në varësi të modelit të metodave të përziera. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 178-190
8	Provim Gjysmëfinal
9	Hipoteza dhe Pyetje kërkimore • Shkrimi i një drafti për një pyetje qendrore cilësore (hipotezë) • Marrja parasysh se si do të ndryshonte ky skenar në varësi të modelit cilësor; • Shkrimi i një skenari për pyetje dhe hipoteza sasiore kërkimore; • Marrja parasysh se si do të ndryshonte ky skenar në varësi të modelit sasiore dhe llojeve të ndryshme të hipotezave; • Përdorimi i një modeli për pyetje dhe hipoteza sasiore përshkruese dhe përfundimtare; • Shkrimi i formave të ndryshme të pyetjeve kërkimore për një studim me metoda të përziera. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 191-205
10	Metodat sasiore • Përdorimi i një liste kontrolluese për hulumtimet me sondazhe për të formuar seksione tematike mbi një formë anketimi; • Hapat që ndiqen në analizimin e të dhënave në një studim; • Zhvillimi i një diskutimi të plotë mbi metodat e anketimit; • Përdorimi i një liste kontrolli për kërkime eksperimentale për të formuar seksione për një procedurë eksperimentale; • Identifikimi i llojit të procedurës eksperimentale që i përshtatet më së miri studimit tuaj të propozuar • Identifikimi i kërcënimeve të vlefshme të brendshme dhe të jashtme të mundshme për studimin e propozuar. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 206-252
11	Metodat Cilësore • Përdorimi i një liste kontrolluese për kërkime cilësore për të formuar seksione tematike të një punimi; • Aplikimi i karakteristikave themelore të kërkimit cilësor; • Përcaktimi se si reflektiviteti do të përfshihet në një studim të propozuar; • Analizimi i llojeve të ndryshme të të dhënave të mbledhura në kërkimin cilësor; • Ndjekja e hapave në procesin e analizës cilësore të të dhënave; • Vlefshmëria e kërkimit cilësor. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 253-293

12	Metodat e përziera dhe Analiza e të dhënave • Përkufizimi dhe karakteristikat e hulumtimit të metodave të përziera • Përdorimi i një modeli konvergjent të metodave të përziera • Përdorimi i një dizajni shpjegues të metodave të përziera sekuenciale • Përdorimi i një dizajni metodash të përziera sekuenciale eksploruese • Përdorimi i një prej modeleve komplekse të metodave të përziera • Zgjedhja e modelit më të mirë për një studim të metodave të përziera • Shpjegimi dhe aplikimi i analizës semiotike; • Shpjegimi dhe aplikimi i analizës retorike; • Përdorimi i kritikizmit ideologjik, ose pikëpamja kritike; • Aplikimi i kritikizmit psiko-analitik • Parimet e analizës së diskutit ligjërim. "Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018, faqe 294-326 "Media and communication research methods" Arthur Asa Berger, Sage, New York 2016, faqe 57-169
13	Shkrimi i përfundimeve, bibliografia dhe shtojcat • Shkrimi dhe rëndësia e përfundimeve në një punim shkencor; • Shkrimi dhe rëndësia e rekomandimeve; • Bibliografia dhe paraqitja e evidencave "Mjeshtria e Hulumtimit: Si të shkruash thjesht dhe qartë". Wayne C. Booth; Gregory C. Colomb; Joseph M. Williams; Joseph Bizub; William T. Fitzgerald, Papirus, Tiranë 2016, faqe 275-291
14	Shkrimet e tjera formale dhe komunikimet në organizata dhe institucione • Shkrimi i një emaili zyrtar; • Mënyrat e shkrimit të një CV-je; • Si shkruhet një memo dhe si shkruhet një raport; • Mënyrat e formatimit të tekstit, citimet, tabelat, figurat dhe rëndësia e paraqitjes grafike; Leksione nga lektori i lëndës
15	Prezantimi i projekt-propozimeve për kërkim
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • Research Design; Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods" John W. Creswell; J. David Creswell; Sage, New York 2018 • Mjeshtria e Hulumtimit: Si të shkruash thjesht dhe qartë". Wayne C. Booth; Gregory C. Colomb; Joseph M. Williams; Joseph Bizub; William T. Fitzgerald, Papirus, Tiranë 2016 • "Media and communication research methods" Arthur Asa Berger, Sage, New York 2016	
Referenca të tjera • Roger D. Wimmer, Joseph R. Dominick. Mass Media Research • Manjola Zaçellari, Suela Kastrati. Shkrimi Akademik. Mileniumi i Ri, 2017, Tiranë. • "Social Media Research Method" Luke Sloan; Anabel Quan-Hasas, Sage Pub, New York 2017 • "Si shkruhet një punim diplome", Umberto Eco, Dituria, Tiranë 2006	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studenti duhet të jetë në thellimin e njohurive shkencore dhe profesionale, si një lëmë i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm, për krijim, pavarësim dhe aftësim në kryerjen e punëve lidhur me studimet kërkimore dhe më gjerë.
2	Studenti duhet të mendojë në mënyrë kritike lidhur aktin e ndjeshmërisë së veprave kërkimore si dhe të kuptuarit e tyre.
3	Studenti duhet të mendojë në mënyrë kritike lidhur aktin e ndjeshmërisë së veprave kërkimore si dhe të kuptuarit e tyre.
4	Studenti duhet të bëjë shqyrtime teorike duke kaluar në veprime konkrete, në hulumtime, observime dhe hartime të punëve profesionale

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	25	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	30	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	15	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			70
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			30
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	5	70
Detyra	1	2	2
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	3	3
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00